

	Emri i institucionit: <b>DREJTORIA E PËRGJITHSHME E STANDARDIZIMIT</b>	Dokumenti Nr.: <b>RC/DS/117</b>	
	Titulli: <b>Plani strategjik i biznesit për DPS/KT</b>	Versioni: <b>01</b>	Faqe Nr.: <b>Faqe 1/3</b>

*PSB, 24.11.2021*

## **Titulli i DPS/KT:**

### **DPS/KT 47 “Kimia”**

#### **A Historiku**

DPS/KT 47 është krijuar në 14.02.2002, në përputhje me Ligjin Nr. 9870 “Për Standardizimin”, i ndryshuar dhe rregulloret e brendshme të DPS në përputhje me rregulloret/udhëzuesit dhe strategjitë e CEN/CENELEC dhe ISO/IEC, mbi krijimin dhe funksionimin e Komiteteve Teknike.

Fusha e këtij KT është adoptimi i standardeve evropiane dhe ndërkombëtare CEN/ISO në lidhje me industrinë kimike në përgjithësi e cila përfshin kimikate dhe substanca kimike themelore të cilat nuk përfshihen në komitete teknike të tjera.

#### **B Mjedisi i biznesit**

##### **B.1 Të përgjithshme**

Puna e KT DPS/KT 47 vazhdon me një ritëm të shpejtë për shkak të zgjerimit të projekteve të ndryshme që kanë lidhje me fushën e kimisë si dhe për identifikimin e përfitimeve që priten nga standardet ndërkombëtare dhe evropiane që zbatohen në këtë fushë. Standardet e adoptuara nga ky KT janë shumë të rëndësishme pasi ka ndihmuar mjaft industrinë kimike të ketë një rritje të ndjeshme në treg kohët e fundit ,si dhe në substancat kimike thelbësore të cilat kanë shkaktuar një përparim relativisht të madh.

##### **B.2 Treguesit sasiorë të mjedisit të biznesit**

Përdoruesit e standardeve të adoptuara nga KT DPS/KT 47 përfshijnë konsumatorët, organizmat e certifikimit, përfaqësimet e drejtpëdrejta nëpërmjet shoqatave të konsumatorit, laboratorët e testimit të provave, dhe autoritetet kombëtare të inspektimit.

Standardet e adoptuara nga ky KT kanë përdorim të gjerë dhe synojnë:

- përmirësimin e cilësisë së produktit;
- kontrollin e prodhimit;
- sigurinë e cilësisë;
- përmirësimin e konkurrencës;

#### **C Përfitimet**

Puna e DPS/KT 47 duhet të rezultojë në adoptimin e standardeve që do të mundësojnë:

- harmonizimin dhe optimizimin e metodave analitike për karakterizimin e surfaktantëve ose papastërtive;
- harmonizimin dhe sqarimin e metodave të provës duke lejuar teknikën e paqartë;
- specifikimet dhe përkufizimin e agjentëve kimikë

	Emri i institucionit: <b>DREJTORIA E PËRGJITHSHME E STANDARDIZIMIT</b>	Dokumenti Nr.: <b>RC/DS/117</b>	
	Titulli: <b>Plani strategjik i biznesit për DPS/KT</b>	Versioni: <b>01</b>	Faqe Nr.: <b>Faqe 2/3</b>

- rritjen e riprodhueshmërisë së metodave të testimit me anë të testimit ndërkrahasues;
- mbështetjen për legjislacionin evropian;
- aspektet lidhur me mjedisin e jashtëm;
- sigurimin e specifikimeve teknike të duhura të standardeve evropiane (EN);
- ruajtjen e interesave dhe nevojat ekonomike të prodhimit.

## D Pjesëmarrja në DPS/KT47

Në DPS/KT 47 ka përfaqësues nga subjekte private, Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial, Drejtoria e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, laboratorë inspektimi si dhe nga Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare i cili merret direkt me analizën për treguesit cilësor tek prodhimet me origjinë bimore të prodhuara në vend, kryen analiza për identifikimin e lëndëve kimike në produktet ushqimore, gjithashtu ka dhe përfaqësues nga Laboratori privat Biochem NRP Ltd i cili është një laborator me një përvojë shumëvjeçare në fushën e diagnostikimit, tregëtimit të reagenteve kimike dhe aparaturave laboratorike. Palët e interesuara në raste të veçanta për probleme specifike mund të emërojnë ekspertët e tyre në grupet e punës të ngritura nga KT për çështje specifike.

## E Objektivat dhe strategjitë

### E.1 Objektivat e përcaktuara nga DPS/KT47

- Miratimi i standardeve, në përputhje me procedurat për hartimin dhe adoptimin e standardeve shqiptare dhe dokumentet e tjera të standardizimit, për sigurinë e produkteve kimike që mbulohen nga ky KT, duke përgatitur çdo vit programin e punës së KT;
- Adoptimin e standardeve të harmonizuara nën direktivën (Rregulloren Nr 1907/2006) “Substancat kimike” në masën 100 %, duke bërë ndryshimet në listën e standardeve nën këtë Rregullore sa herë që ato përditësohen;
- Përfaqësimi i interesave kombëtare në organizmat evropiane dhe ndërkombëtare kur ajo kërkohet;
- Aplikimi i parimeve themelore të standardizimit;
- Përgatitja dhe pasurimi me terma të reja të fushës i fjalorit terminologjik;

### E.2 Strategjitë e përcaktuara për arritjen e objektivave

Përmbushja e objektivave të DPS/KT 47 bazohet në punën për adoptimin e standardeve evropiane dhe ndërkombëtare si standarde shqiptare, duke bashkëpunuar me KT "pasqyrë" të CEN dhe ISO si më poshtë:

CEN/TC 216	Dezinfektantët kimikë dhe antiseptikët
CEN/TC 219	Mbrojtja katodike
CEN/TC 223	Përmirësuesit e tokës dhe mjedisi i rritjes
CEN/TC 260	Plehrat kimike dhe materialet përmirësuese (gëlqeruese)
CEN/TC 276	Agjentët me aktivitet sipërfaqësor
CEN/TC 332	Pajisje laboratorike
CEN/TC 347	Metodat për analizën e alergeneve
CEN/TC 352	Njësitë teknologjike
CEN/SS C03	Kimia
ECISS/TC 102	Metodat për analizat kimike për hekurin dhe çelikun



Emri i institucionit:

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E STANDARDIZIMIT**

Dokumenti Nr.:

RC/DS/117

Titulli:

**Plani strategjik i biznesit për DPS/KT**

Versioni:

01

Faqe Nr.:

Faqe 3/3

CEN/TC 369	Siguria e zjarrit nga qirinjtë
ISO/TC 47	Kimia
ISO/TC 48	Pajisje laboratorike
ISO/TC 158	Analizat e gazeve
CEN/TC 360	Sistemet e veshjes për aparatet kimike dhe impiantet kundër gërryerjes
CEN/TC 363	Ndotësit organik në gazrat prodhues
CEN/TC 386	Fotokataliza

## **F Planifikimi**

Për realizimin e objektivave të mësipërme ky KT bazuar në propozimin e standardeve të reja fillon punën për adoptimin e standardeve.

## **G Financimi**

Kryetari dhe anëtarët punojnë mbi baza vullnetare dhe pa pagesë.

**Sekretari i DPS/KT 47**

**(Elona TELULI)**